



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Programi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile për vitet 2025-2029

Gjatë katër viteve të ardhshme, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri do të vijojë mbështetjen për sektorin dhe aktorët e interesuar përmes një programi edhe më të pasur, të larmishëm dhe gjithëpërfshirës shërbimesh.

Iniciuar në vitin 2019 si një nismë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA), me mbështetjen e Bashkimit Evropian, Qendra është konsoliduar si një platformë e rëndësishme në mbështetje të shoqërisë civile, si në nivel kombëtar, ashtu edhe lokal.

Ajo kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve të sektorit, nxitjen e dialogut në politikëbërje dhe përmirësimin e mjedisit në të cilin veprojnë organizatat e shoqërisë civile.

Duke ndërtuar mbi këto përvoja, gjatë periudhës 2025-2029, Qendra do të vazhdojë të mbështesë organizatat, rrjetet e tyre, grupimet informale, aktivistët dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile përmes zyrave në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, si dhe përmes shërbimeve online dhe aktiviteteve të zhvilluara në qytete të ndryshme të vendit.

SHËRBIMET TONA BAZOHEN NË PESË SHTYLLA THEMELORE:



Afër organizatave, aty ku ato veprojnë - tre qendra rajonale dhe njësi lëvizëse për të garantuar akses dhe afërsi reale;



Mbështetje e përshtatur sipas nevojës - trajnime, mentorim dhe asistencë ligjore që pasqyrojnë realisht sfidat dhe prioritetet e organizatave;




Qasjet tona pasqyrojnë **realitetin në të cilin veprojnë organizatat**, të ndikuar jo vetëm nga dinamika lokale e kombëtare, por edhe nga zhvillimet në nivel rajonal, evropian dhe global që prekin sektorin e shoqërisë civile;



Praktika të udhëhequra nga përvoja në terren - veprimtaria jonë bazohet në përvojën konkrete me organizatat dhe jo vetëm në dokumente politike apo strategjike;



Bashkëpunim në thelb - lidhje të qëndrueshme mes OSHC-ve, institucioneve publike, akademisë dhe donatorëve për të ndërtuar mirëkuptim dhe veprim të përbashkët.



SHËRBIM MBËSHTETËS DHE INFORMIM

Informacion

- mbi (i) Sektorin jofitimprurës, kuadrin ligjor dhe zhvillimet e sektorit për OSHC-të, rrjetet e OSHC-ve, donatorë, institucione, dhe aktorë të tjerë të interesuar brenda dhe jashtë vendit;
- (ii) Mundësi financimi në vend, rajon, Evropë e më gjerë në nivel global;
- (iii) Procese konsultuese të institucioneve në nivel qendror e vendor, Parlamentit, donatorëve etj.,
- (iv) Evente publike të hapura për pjesëmarrje për OShC-të etj.

Asistencë direkte dhe online

për organizatat dhe rrjetet e OSHC-ve për të adresuar nevojat e tyre për zhvillim organizativ dhe nisma advokuese.

SHËRBIM LIGJOR PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE, GRUPIMET INFORMALE TË AKTIVISTËVE

Si pjesë këtij shërbimi Qendra Burimore do të ofrojë:

- (i) **Informim dhe Edukim Ligjor për OJF-të** lidhur me aksesin në institucionet e administratës publike, aksesin në sistemin gjyqësor të subjekteve OJF, udhëzime të përgjithshme për formalitet e kërkesave / kërkesë-padive, procedurat, etj.
- (ii) **Këshillim ligjor në lidhje me:** krijimin, funksionimin, çregjistrimin ligjor për OJF; licencimin e OJF-ve, regjimin tatimor për OJF (veprimtari jofitimprurëse jo-ekonomike dhe ekonomike); detyrime të OJF për deklarime dhe raportime; legjislacioni AML dhe CFT (kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit) i zbatueshëm për OJF; OJF-të si punëdhënës dhe në marrëdhëniet me vullnetarët; marrëdhëniet kontraktore, përfshirë kontrata financimi etj.

Më shumë informacion lidhur me këtë shërbim dhe si mund të përfitoni prej tij gjendet [këtu](#).



RRJETËZIM PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Në nivel lokal, kombëtar, rajonal e më gjerë. Qendra do të vazhdojë pasurimin e [Direktorisë online të OSHC-ve](#) në faqen e internetit të Qendrës Burimore; pasurimin e informimit për rrjete organizatash në vend, rajon e më gjerë si dhe organizimin e eventeve rrjetëzuese.



NDËRMARRJE E NISMAVE ADVOKUESE, LEHTËSIM I PËRPJEKJEVE ADVOKUESE TË SEKTORIT DHE DIALOGUT NDËRINSTITUCIONAL

Për një pjesëmarrje më të madhe dhe më efektive në politikëbërje dhe zbatim.



MBËSHTETJE PËR OSHC-TË PËR ARRITJEN E STANDARDEVE MË TË LARTA

Në qeverisjen e organizatave; manaxhimin e burimore njerëzore dhe financiare; transparencën dhe llogaridhënien ndaj përfituesve, anëtarëve e mbështetësve; advokimin e përgjegjshëm dhe ndërtimin e partneriteteve dhe rritjen e besimit të publikut. Qendra Burimore do të vijojë të shërbejë si [Sekretariat i Kodit të Standardeve për OSHC-të në Shqipëri](#), duke synuar të përmirësojë efektivitetin e punës së organizatave jofitimprurëse dhe rritjen e besimit të publikut në sektor.



FUQIZIM KAPACITETESH DHE ASISTENCË PËR OSHC-TË, RRJETET DHE GRUPIMET E SHOQËRISË CIVILE

Bazuar në vlerësimet e përvitshme të nevojave të sektorit dhe në zhvillimet dinamike që e ndikojnë atë, Qendra do të vijojë të ofrojë mbështetje përmes programeve të trajnimit dhe mentorimit për OSHC-të, rrjetet, koalicionet dhe grupimet informale, me synimin për të rritur kapacitetet, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e tyre në përmbushjen e misionit.

Programe në vijim

- >>> **Akademia e OJF-ve**, një program vjetor që kontribuon në rritjen e kapaciteteve të drejtuesve dhe menaxherëve të OJF-ve. Iniciuar që prej vitit 2015 nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Akademia e OJF-ve është konsoliduar si një program edukimi dhe zhvillimi joformal për përf forcimin e aftësive dhe kompetencave të drejtuesve dhe menaxherëve të organizatave të shoqërisë civile në mbarë vendin, nëpërmjet një kurrikule unike, metodave më bashkëkohore të të nxënimit si dhe përvojave shumëdimensionale të shkëmbimit të eksperiencave nga vendi, rajoni, Evropa e më gjerë.
- >>> **Programe trajnimi rajonale** në përgjigje të kërkesave specifike të organizatave, si dhe të nevojave të identifikuara përmes vlerësimeve periodike të Qendrës.
- >>> **“Manaxhim dhe monitorim i granteve”**- program trajnimi dizenuar për organizata të cilat ofrojnë mbështetje financiare për OSHC të tjera, përmes skemave të ndryshme të nën-grantimit kryesisht me fonde të BE-së dhe donatorëve të tjerë;
- >>> **“Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE”** – programe rajonale trajnimi dhe mentorimi të OSHC-ve nga mbarë vendi për të rritur njohuritë dhe procesit të akreditimit për t’u bërë pjesë e programeve të vullnetarizmit në nivel Evropian.
- >>> **“EU aquis, angazhimi dhe roli i OSHC-ve në procesin e integritetit të vendit në BE”** – programe rajonale periodike trajnimesh për forcimin e mëtejshëm të njohurive të OSHC-ve dhe rritjen e kontributit të tyre në grupet ndër-institucionale të punës, përgjatë fazave të procesit të integritetit evropian dhe negociatave për pranimin në BE.
- >>> **Java Kombëtare e Shoqërisë Civile**: një nismë e konsoliduar e Qendrës, dedikuar promovimit të sektorit të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Çdo vit, përmes një serie eventesh të organizuara nga vetë OSHC-të, Java ofron më shumë mundësi për rrjetëzim, dialog ndër-institucional dhe ndërgjegjësim publik mbi rolin dhe kontributin e sektorit në zhvillimin demokratik dhe social të vendit. Ajo shërben gjithashtu si një hapësirë për bashkëpunim dhe angazhim të përbashkët, duke vendosur në qendër të vëmendjes punën dhe ndikimin konkret të organizatave në komunitet.



NEW Programe të reja

- >>> **Akademia e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të**: një program profesional dhe i certifikuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, i krijuar për të fuqizuar njohuritë dhe aftësitë e menaxherëve dhe specialistëve të financës në sektorin jofitimprurës. Programi ofron një zhvillim të thelluar profesional bazuar në standarde të avancuara dhe praktika bashkëkohore të menaxhimit financiar, duke i pajisur pjesëmarrësit me mjetet e nevojshme për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien brenda organizatave të tyre. E konceptuar për t’iu përgjigjur sfidave reale të menaxhimit financiar, Akademia kontribuon në rritjen e qëndrueshmërisë së organizatave dhe në ndërtimin e kapaciteteve financiare të nevojshme për një sektor më të përgjegjshëm dhe transparent.
- >>> **Platforma Nën-Sektoriale Tematike për Nisma të Koordinuara dhe Advokim**: programi synon të mbështesë krijimin dhe funksionimin e platformave tematike të organizatave të shoqërisë civile në fusha të ndryshme si qeverisja e mirë, shërbimet sociale, të drejtat e njeriut, mjedisi dhe fusha të tjera me interes për sektorin. Përmes mentorimit, lehtësimit të bashkëpunimit dhe angazhimit të

✦ ekspertëve sipas fushave përkatëse, programi krijon hapësira për nisma të përbashkëta dhe advokim të koordinuar, si në nivel lokal ashtu edhe kombëtar.

Platformat do të shërbejnë si mekanizma bashkëpunimi dhe ndikimi, duke kontribuar në dialogun ndërsektorial, tryezat tematike me institucionet publike dhe pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në procesin e integritit evropian dhe agjendën reformuese të vendit.

Risi **Qendra Burimore Lëvizëse:** tur vjetor me aktivitete, që synon të nxisë mobilizimin qytetar dhe të rrisë pjesëmarrjen në hapësirën publike, duke afruar burimet dhe ekspertizën e Qendrës pranë organizatave që veprojnë jashtë Tiranës.

>>> Afër Ndikimit - Takime me Gazetarë dhe Vizita në Terren: programi synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet medias dhe organizatave të shoqërisë civile, duke krijuar mundësi për njohje të drejtpërdrejtë me realitetin në të cilin veprojnë OJF-të në komunitet.

Këto takime ndihmojnë në nxjerrjen në pah të ndikimit të punës së organizatave, nxisin raportim më të informuar dhe cilësor, dhe rrisin vëmendjen publike ndaj çështjeve që trajton sektori jofitimprurës. Njëkohësisht, ato kontribuojnë në rritjen e vizibilitetit dhe besueshmërisë së shoqërisë civile si aktor i rëndësishëm në zhvillimin demokratik dhe social të vendit.

